

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurës M.M - K, për shkak të veprës penale Lëndimi te rëndë trupor nga neni 189 par. 5 të KPRK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I. nr 60/17 të dt. 28.04.2017, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 07.07.2017, në të cilën ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit – Hivzi Bajraktari, e pandehura M.M-K, i dëmtuari D.K, si dhe mbrojtësi av H.M sipas autorizimit, gjykata të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

E pandehura: M.M-K, e bija e I dhe Z, i lindur me dt. *data e lindjes* në fshatin D-K, Republika e Shqipërisë, me vendbanim në rrugën e "...", p.n, F K, punon në Hekurudhën e Kosovës " I K" (...) ,e martuar, nënë e pesë fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal *numer personal* shqiptare, shtetase e Republikës së Shqipërisë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me datë 05.04.2017 ne orët e hershme të mëngjesit, respektivisht në shtëpinë e saj e cila gjendet në F K, rr."..."p.n pas një mosmarrëveshje e bashkëshortin e saj të dëmtuarin D.K duke përdor mjetin e rrezikshëm – armën e ftohtë – thikën (mjet i përshtatshëm për shkakimin e lëndimeve të rënda trupore) e ka goditur fizikisht të dëmtuarin në bark duke i shkakuar të njëjtit lëndime të rënda trupore në stomak të cilësuar si plagë prerëse shpuse dhe tej shkuse të barkut me gjak mbledhje në regjionin e zorrëve, sipas mendimit të ekspertit mjeko ligjor Dr. Naim Uka të dt. 23.04.2017.

- Me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi te rëndë trupor nga neni 189 par. 5 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,49,50,51,52,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurës **M.M-K**, i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili nuk do të ekzekutohet në rast se e pandehura nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej **2 (dy) viti**.

Obligohet e pandehura qe te paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej **30 euro**, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet: një armë e ftohtë (thikë).

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I. nr 60/17 të dt. 28.04.2017, me të cilën e ka akuzuar të pandehurën M.M-K, për shkak të veprës penale Lëndimi të rëndë trupor nga neni 189 par. 5 të KPRK-së.

Me datë 07.07.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I. nr 60/17 të dt. 28.04.2017, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykues pasi që u bind se e pandehura e ka kuptuar akuzën, të njëjtes i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohej e pafajshme.

E pandehura M.M-K, në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, duke shtuar se këtë e kishte bërë edhe momentin e parë kur ka ndodhur rasti. Se ka sqaruar rastin edhe para organeve tjera, krejt ajo kishte qenë momentale.

Mbrojtësi av H.M, pas deklarimit të të mbrojturës së tij, në shqyrtim fillestare mes tjerash ka deklaruar: se me të mbrojturën e tij ishte konsultuar dhe i ka sqaruar institutin e pranimit të fajësisë benefitet dhe pasojat që i ofron ligji konform dispozitave ligjore, me vullnet është deklaruar, pa presion, dhunë apo lajthitje, me vullnet të shprehur është deklaruar në të gjitha fazat e procedurës ka pranuar veprimet që i ka ndërmarr e mbrojtura e tij, gjithashtu konform ligjit ekzistojnë edhe prova të mjaftueshme në shkresat e lëndës, andaj i propozojë gjykatës edhe prokurorisë që të akceptojë pranimin e fajësisë dhe sigurisht pas pranimit të fajësisë të pranuar nga Gjykata të ketë parasysh të gjitha rrethanat e favorshme dhe në mënyrë të posaçme rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen e dënimit pasi që i dëmtuari dhe e mbrojtura e tij jetojnë së bashku, kanë fëmijë të përbashkët, pas incidentit raportet janë rehabilituar në tërësi nuk ka ndodhur më as fjalosje e le më ndonjë konflikt verbal, rrethanat janë në shkresat e lëndës, e mbrojtura e tij thotë që në mënyrë afektive dhe pa kontroll ka reaguuar dhe pastaj vet e ka mjekuar të dëmtuarin te rehabilitoj plagën derisa të dorëzohet në spital, dhe duke kuptuar edhe në kuptimin e preventivës dhe represive për këtë vepër ashtu siç është cilësuar të keni parasysh që të shqiptoni një dënim nën minimumin ligjore nëse gjeni hapësirë ligjore edhe të kushtëzuar me premtimin se kjo nuk do të përsëritet, dhe keqardhjen që çdo herë e ka shprehur e mbrojtura e tij në gjitha fazat e procedurës. Duke shtuar se meqenëse gjykata nuk është e lidhur për cilësimin e juridik konsiderojë se me veprimet e të mbrojturës së tij janë paraqitur elementet e figurës që përkrijnë në plotëni me Lëndimin e rëndë trupor nga neni 189/1 nën par 1.3 të KPRK-së, sepse dëmtimet kanë qenë të përkohshme, pasojat kanë qenë të përkohshme, dhe vet i dëmtuari deklarojë se ka qëndruar vetëm 1 javë në spital, dhe nëse gjykata vlerëson që vendimi mbi dënimin mund të shqiptohet deri në 6 muaj, sa është minimumi ligjore, atëherë të aplikojë dispozitat me deklarin e të mbrojturës së tij që me vullnetin e saj të pranojë që ky dënim të shndërrohet në dënim me gjobë.

Prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari pas deklarimit të të pandehurës, dhe dëgjimit të mbrojturit të saj, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës duke konsideruar se pranimi i fajësisë është komfor KPPK-së, si dhe në përputhje me provat e propozuara nga prokuroria, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë dhe që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, e pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, siç janë: deklarata e të pandehurës dhënë në polici dhe pranë prokurorit të çështjes në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Vërtetimi i lëshuar nga Policia e Kosovës mbi konfiskimin e armës së ftoht – thikës, mendimi i ekspertit ligjore dr Naim Uka dt 23.04.2017

lidhur me natyrën e lëndimeve të të dëmtuarit D.K, dokumentacioni mjekësore për të dëmtuarin D.K, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurën mori pranimin e fajësisë nga e pandehura, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurës, rrethanat e saj familjare, e njëjta është e martuar, nënë e pesë fëmijëve, mbajtëse e vetme e familjes, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurës i shqiptoi dënim burgimi me kusht si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. Nr 151/17, datë 07.07.2017

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.